



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 2584/I Prot.

Vlorë, më 24/08/2023

V E N D I M N r. 6 5

Sot, më datë 24/08/2023, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit "RAFAEL SHOES" sh.p.k me NIPT L93102401C, me seli në Fier (Lagjja "Afrim", Rruga "Afrim i Ri", z. K 8534, Pasuria nr 15/64), si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0007848, nr.2584 Prot., datë 24/08/2023, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

K O N S T A T O V A S E :

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa me Nr.441/10 Prot., datë 19/07/2023, protokolluar me Tonën me nr.144/10, datë 20/07/2023, me lëndë "Dërgohet Raporti Përfundimtar për auditimin e kryer në Doganën Vlorë". Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, nga Dega e Doganës Vlorë u hartua "Plani i Punës" me nr.144/11 Prot., datë 04/08/2023, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga ana e Grupit të Punës është kryer rishqyrtimi i rekomandimit të lënë ndaj këtij subjekti.

Nga kontrollin dhe verifikimi i kryer, mbi autorizimin e regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë të subjektit "Rafael Shoes" me Nipt L93102401C, përfaqësuar nga agjencia doganore "Gad Universi" – J 102, subjekti ka kryer procedurat e importit me deklaratat doganore IM. 5, duke kryer hyrje të mallrave "Forma 352 Pale", me periudhën kohore të shkarkimit të rieksporit për 12 muaj, sipas bilanceve të autorizimeve dhe procedurave të zgjeruara në sasi të si më poshtë :

Autorizimi: P20210621/1914/1

Txt Rsv: P20210621/1914/1							Tar Prc Ext	Data
							5300	
Date	Dav-i	Tip	Kompani Name	NK	Pershkrimi	P. Net	Vlera	
21/06/2021	8128	IM	5	RAFAEL SHOES - SHPK	39269097	FORMA 352 PALE	110	1,056
Grand Total							110	1,056

Nga kontrolli në sistemin Asycuda dhe e dosjes me dokumentacionin fizik të subjektit përfitues i këtij autorizimi u konstatua se afati i autorizimit dhe shtesat e afateve të miratuar për subjektin kanë përfunduar, ndërkohë që subjekti nuk i ka dhënë destinacion doganor mallrave të importuara në RLP dhe nuk ka depozituar në Degën e Doganës Vlorë kërkesën për shtyrjen e afatit të rieksporit.

Për këto arsye, në mbarimin e vlefshmërisë së autorizimit për mallrat nën regjim, bazuar në nenin, 250-1-a, 252-a dhe 257-1-b, të ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, linden detyrimet doganore dhe penalizimi në shumën 50.000 lekë.

Gjatë kontrollit në Sistemin Asycuda (Processing Program and CUO) autorizimi del i mbyllur dhe nuk ka shtyrje të afatit kohor. Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni shkresor, ranimit në sistemin Data base kombëtar dhe sistemit Asycuda World, subjekti duhet penalizohet për mos respektim të kërkesave të vendosura në autorizim. Pagesa e gjobës që zbatohet për shkeljen doganore, në asnjë rast, nuk është shkak për të përjashtuar shkelësin nga pagimi i detyrimeve të importit ose eksportit që duhen paguar për mallrat, objekt i shkeljes në zbatim të kërkesave të nenit 250-4 të Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar në kushtet kur subjekti i jep destinacion doganor nëpërmjet hedhjes për qakullim të lirë më procedurën e zgjeruar *4053*.

Rezulton se Dega e Doganës Vlorë, bazuar në nenin 41 e në vijim të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, ka proceduar me shkresën Nr.1878 Prot., datë 27/06/2023 me lëndë “Njoftim mbi fillimin e procedurës administrative”, me të cilën ka njoftuar subjektin për fillimin e procedurës administrative. Gjithashtu, Dega e Doganës Vlorë, ka proceduar edhe me njoftimin elektronik, me email-n e datës 29/06/2023, ora 09:34, me lëndë “Njoftim mbi fillimin e procedurës administrative”.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : “Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”,

V E N D O S A :

- Subjekti “RAFAEL SHOES” sh.p.k me NIPT L93102401C, me seli në Fier, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **31.100** (Tridhjetë e njëmijë e njëqind) lekë, për deklaratën doganore IMP. 5 me numër R 8128, datë 21/06/2021, ose regjim doganor mallit (rieksort).

- Subjekti "RAFAEL SHOES" sh.p.k me NIPT L93102401C të penalizohet në shumën **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Zyra e Mbikqyrjes Doganore të procedojë me mundësimin dhe vënien e mallrave përkatës në regjimin doganor të duhur, konform përcaktimeve të legjislacionit doganor për regjimin në fjalë.
- Kundër këtij vendimi, subjekti "RAFAEL SHOES" sh.p.k me NIPT L93102401C, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijëni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke mbyllur paraprakisht regjimin doganor - parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt dhënies regjim doganor mallit), si dhe duke garantuar 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".

KRYETAR
Artan Bedinaj

